



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

01 Numër: 91/2022

Data: 21.06.2022



Komuna e Istog

Opština Istok

Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 5-të të rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **29.06.2022, e Mërkure**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së) për vitin 2022,
4. Shqyrtimi dhe Miratimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për Ndryshim – Plotësimin e Vendimit 01Nr.35/2022, i datës 31.03.2022 për themelimin e KKSB, me një anëtar të ri,
5. Formimi i komisionit vlerësuese për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës,
6. Formimin e komisionit për ankesa ndaj dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës,
7. Njoftimi me raportin vjetor të punës së prokurimit për vitin 2021,
8. Njoftimi me Planin e Punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2022,
9. Shqyrtimi dhe Miratimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025,
10. Shqyrtimi dhe Miratimi i listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022,
11. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Z. Enver Rugova

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e katërt e rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.05.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Negdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Niman Begiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Melis Smakic, GIBI</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: nënkryetari i komunës, z. Ali Nimanaj, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hapi punimet për mbledhjen e katërt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes (25) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Procesverbali

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 29.04.2022,
4. Njoftimi me Raportin vjetor të punës NPL “Ambienti” për vitin 2021,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të ndarjeve buxhetore për tejkalimin e THV 1 2021,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2020 dhe 2021,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike, 38 Rezerva në Kategorinë Ekonomike, 30-Shpenzime Kapitale,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 25 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- nëse nuk ka dikush diçka e hedh në votim rendin e ditës për mbledhjen e sotme? Kush është për?

Konstatojmë që me 25 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje të pranishëm janë 25 anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit-në mbledhjen e sotme mungojnë dy anëtarë të Kuvendit, e kam lajmërimin nga z. Qerim Rexhaj i cili nuk do jetë sot i pranishëm për shkaqe shëndetësore, dhe Fjolla Ukaj pa ndonjë njoftim për mungesën e saj.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- duhet të debatojmë pak rreth procesverbaleve, ne e kemi edhe procesverbalin e miratuar me vërejtje të datës 31.03.2022 që anëtarët e Kuvendit kanë dhënë vërejtje, e kanë plotësuar sekretaria, dhe kjo në web-faqen e komunës do të dalë si e përmirësuar me vërejtjet e juaja, pra ky procesverbal është votuar në mbledhjen e

kaluar. Procesverbali i datës 29.04.2022 me kërkesën edhe të juaj , ky në fakt është transkript dhe jo procesverbal, sepse përbëhet prej 45 faqeve, nuk është mirë me na ndodhur neve si komunë, sepse kjo publikohet në web-faqen e komunës dhe as për mua as për ju, nuk e mirë të dalë në publik çdo gjë që thuhet këtu, por me e nxjerrë një thelb. Po ju lutem që mos të jetë më kështu, sepse vërtetë edhe ministria atje dhe OJQ-të na kanë dhënë vërejtje pikërisht për këtë.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka kërkuar fjalën?

Ajshe Metaj- unë nuk kam asgjë që të shkoj në mënyrë të zgjeruar, por edhe në atë mënyrën konceptuale nuk dalin diskutimet siç duhet, sepse konceptet jo gjithmonë japin kuptimin e asaj që po e thua. Unë nuk besoj, se të njëjtin e kemi pasur në mandatin e kaluar, dhe asnjë vërejtje nuk e kemi pasur prej OJQ-ve as prej askujt. Ju mund ta bëni si të doni, unë nuk jam ashtu për mënyrën konceptuale, nuk jam për koncepte të shkurtra, një problem që diskutohet me një fjali. Konceptet unë i mirëpres se e paraqesin një thelb, por ai do diskutim, rreth një koncepti duhet të diskutohet. Kështu që unë nuk jam për atë mënyrën si keni shkruar ju. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Nuk e kisha ndërmend ta marrë sot fjalën për procesverbalin, por kisha propozuar me qenë procesverbal jo transkript, në qoftë se ka diçka që mungon, ne japim vërejtje. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- po kam dëshirë për procesverbalin me e bërë një konsensus. Kjo na përfshinë të gjithëve, vetëm parlamenti bën transkript, dhe ne nuk bën të shkojmë në këtë mënyrë. Megjithatë po e hedh në votim kështu siç është, kush është që të miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 29.04.2022?

Konstatohet që me 25 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 29.04.2022.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- nënkryetari fjala është për ju.

Nënkryetari i komunës- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket raportit në ndërmarrjes publike KRM “Ambienti” besoj që materialin e keni pasur të gjithë të pranuar me kohë, për më detaje e ftoj drejtorin e drejtorisë për Shërbime Publike z. Abedin Kabashi që ta marrë fjalën.

Kryesuesi i Kuvendit- menaxheri i kompanisë “Ambienti” e ka fjalën.

Alferd Tahirsylaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Dhe prezanton raportin vjetor të kompanisë “Ambienti” për vitin 2021.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë. E hapi debatin rreth kësaj pike. Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- faleminderit kryesues! Për këtë njësinë “Ambienti” janë dhënë shumë të dhëna, por janë paraqitur shumë shkurt. Por në mesin e këtij materiali janë disa pyetje që unë i kisha bërë për menaxherin e kësaj kompanie. Këtu është punuar në këtë kompani sepse rezultatet janë parë. Janë përmendur borxhet që ja kanë kompanisë, pra pyetja ime për menaxherin është sa borxh i kanë qytetarët kompanisë, pasi që aty u pa një numër 8 mijë e 800, euro ata ja kanë dhënë vetëm përmbaruesit. Pra a i kanë marrë ato të holla sepse kur angazhohet përmbaruesi aty nuk diskutohet. Dhe ku i kanë shfrytëzuar ato mjete që ja u ka nxjerrë përmbaruesi ? Gjithashtu e kam parë në shënime janë dhjetë kamionë dhe një traktor, këtu janë gjashtë vozitës, dhe po mbasin katër kamionë pa u angazhuar. Pastaj rreth kontejnerëve, janë shpërndarë njëherë pastaj janë mbledhur, arsyet kanë qenë të ndryshme, këtu është thënë se heqja e kontejnerëve është bërë se kanë qenë të dëmtuar dhe për shkak të pamundësisë së blerjes së tyre, me sa e kam parë në fshatin tim ka qenë një i dëmtuar, ndoshta ka qenë ndonjë arsye tjetër që janë tërheq kontejnerët. Këtu thuhet që janë blerë një sasi e kontejnerëve, me 1.1 m³, 1.3, m³, 1.5 m³, dhe 120 L, këtu po thuhet që janë diku 1333 kontejnerë, janë shpërndarë pa e specifikuar vendin, pra ne edhe qytetarët jemi të interesuar ta dimë se në cilat zona janë shpërndarë. Pastaj kisha dashur ta di, që është thënë se “SIB” kompania ka operuar pastaj është ndërprerë kontrata me të cilat janë shkaqet, pse është ndërprerë kontrata nga kjo kompani? E kam pas ndërmend ta bëj pyetjen se pse GIZI nuk është aktivizuar, por e dha përgjigjen menaxheri, edhe e kam një tjetër këtu faturat mujore që janë lëshuar në muajin dhjetor 2021 nuk e kuptoj janë shtatë me kontratë, pra kam dëshirë ta marrë vesh me e justifikuar çka? Kaq kisha! Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- për shkak të vëllimit të pyetjeve edhe me qenë më transparent fjala është për ju menaxher. Urdhëroni!

Alferd Tahirsylaj- faleminderit Profesoreshë! Sa i përket borxheve të kompanisë që i kanë klientët janë akumuluar prej themelimit apo prej ndarjes së “Hidrodrini” diku llogaritet rreth 600 mijë euro. Mjetet që janë marrë nga përmbaruesi janë shpenzuar për mjetet e punës që duhet të pajisen punëtorët, dhe është bërë zgjerimi me punëtorë të ri. Sa i përket vozitësve, ata duhet me dalë në pushim duhet me i zëvendësuar dikush, kështu që duhet me pasur vozitës më shumë se sa ka automjete, ose sëmuret ndonjë pushimi vjetor i takon me ligj, nuk mundem unë me dalë në teren nëse shoferi del në pushim e me e lënë punën pa e kryer, duhet me pasur mbulesë për zëvendësime. Sa i përket kontejnerëve se nga janë shpërndarë, Istogu është shpërndarë me projektin e GIZI-it, dhe Osejani vitin e kaluar me projektin Let's do it Peja. Arsyet se pse janë hequr kontejnerët janë shumë, ne si kompani veprimtari kryesore e kemi bartjen e mbeturinave të amvisërisë. Ne në kontejnerët 1.1 m³, më shumë kemi hequr mbeturina të ndërtimtarisë se sa të amvisërisë, kanë paraqitur problem së pari për punëtorët pastaj për makinerinë tonë. Pse janë hequr kontejnerët? Besoj që je dëshmitarja më e mirë e lagjes tënde te kontejneri te vend autobusi që ka qenë, qysh ka qenë gjendja para se me qenë kontejneri dhe pasi është heq kontejneri. Pra këto kanë qenë arsyet kryesore pse është dashur të hiqen, modeli më i mirë se pse është dashur të hiqen ka qenë brenda vet kompanisë dhe vet brenda territorit të Istogut, në ato vende ku kemi kryer shërbim pa kontejnerë, mirëmbajtja, ambienti ka qenë shumë më mirë, se aty ku ka pasur kontejnerë. Ne jemi duke kërkuar opsion për me e ngritur cilësinë e shërbimeve, e për ta

bërë këtë duhet me marrë modele ku është më mirë, modelin e kemi pasur brenda kompanisë. Këto bizneset me kontrata janë biznese që bëjnë kontrata për kryerjen e shërbimeve, në bazë të sasisë së mbeturinave janë tarifat që duhet të bëhen, dhe ju nevojiten puna tatimeve të tyre me i pasur me kontrata.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- më vjen mirë që përmbaruesi nuk merr po edhe jap, dhe që i ka nxjerrë ato borxhe, kjo shuma ende është në procedurë, por ju planifikimin si e paskeni bërë, sa punëtorë e keni ndërmend me i pranuar edhe cilat janë ato mjete që ju shkojnë pos kamionit, d.m.th ndonjë doreza a diçka tjetër se po i bie shumë e madhe se nuk po e di se çfarë po blen me mjetet tjera. Nëse nuk ke përgjigje tani nuk ka problem, unë pres, vetëm që po dua të jem korrekt.

Alferd Tahirsylaj- javën e kaluar kanë filluar tre punëtorë të ri, tani jemi në koordinim me drejtorinë e Shërbimeve Publike, për një marrëveshje të re për zgjerim të shërbimeve, në momentin që nënshkruhet ajo marrëveshje, ne kemi nevojë për punëtorë të tjerë, është e planifikuar të zgjerohet. Sa i përket shpenzimeve, nuk bëhet fjalë për disa doreza, por për mijëra doreza, që nuk e kanë më çmimin një euro por dy euro, janë materialet e riparimit të kontejnerëve që kushtojnë minimin një kontejnerë 1.1 m³ kushton afër 150.00 euro, edhe janë materialet tjera shpenzuese, si makinat për kositjen e barit, material për zyrë, pra për pjesë të punës tonë.

Ajshe Metaj- po kyçem edhe njëherë, se po dua t'i kem të qarta, në mënyrë që kur të më pyet dikush së pari me i kuptuar vet, pastaj me i treguar dikujt, e mos me e përhapur informacionin në mënyrë të gabuar. Këtu e kam vetëm edhe një pyetje, a e keni numrin aktual të punëtorëve këtë vit siç ka qenë vitin e kaluar para se me e marrë ju, sa punëtorë keni ju më shumë në krahasim me vitet e kaluara?

Alferd Tahirsylaj- prej që jam unë, jemi pesë punëtorë plus. Po këta hynë në raportin e 6 mujorit të vitit 2022, se tashmë veç kemi filluar me e përgatit 6 mujorin e vitit 2022.

Ajshe Metaj- atëherë edhe me numër më të vogël të punëtorëve meqenëse shtrirja nuk ka qenë aq e madhe dhe siç po thuhet shtrirja po bëhet dita e ditës, d.m.th unë e kam parë që kjo kompani ka operuar gati 98%, është në rregull që e keni zgjeruar veprimtarinë, mirëpo kjo shuma që keni me e marrë prej përmbaruesit diçka nuk po mbulohet me ato materialet që po thua duhet doreza dy euro, ato janë shuma të mëdha të te hollave, kur ke ti kërkesë e fiton lëndën nga gjykata ndërsa ekzekutimin e bën përmbaruesi.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush që dëshiron ta marrë fjalën rreth kësaj pike? Lavdiqe Bujupaj e ka fjalën pastaj Florin Dreshaj.

Lavdiye Bujupaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e pata vetëm një pyetje për menaxherin e ndërmarrjes “Ambienti” mua më intereson ta di statusin e ndërmarrjes “Ambienti” që ende vazhdon të mbetet i pazgjidhur. Dhe kur është e paraparë që kompania të kalojë në kompetenca të komunës. Faleminderit!

Florin Dreshaj- unë së pari kisha dashur t’i përgëzoj për punën që janë duke e bërë, edhe pse ka vend për përmirësim. Vërejtje kam te veprimtaria sekondare, d.m.th mirëmbajtja e parqeve, deponitë, ndërsa sa i përket raportit, raporti ka qenë shumë i varfër, janë disa çështje që nuk u përmenden te përqindja e inkasimit, 101% ose 109% Në njërën anë u tha që ka borxhe në anën tjetër thotë që inkasimi është bërë 100% a kishe mundur të na sqarosh këtë?

Alferd Tahirsylaj- Lavdiye, statusi i ndërmarrjes “Ambienti” është i pazgjidhur, ne si punëtorë këtë status nuk mund ta zgjidhim, por e zgjidhni ju si Kuvend, bashkë me qeverinë e Kosovës, pra kjo zgjidhet në nivel qendror dhe jo prej nesh. Kështu që ju jeni ata që duhet t’i filloni procedurat nëse dëshironi që ne me u shkëput si kompani.

Lavdiye Bujupaj- unë e di që statusi i ndërmarrjes “Ambienti” zgjidhet me vota tona të nivelit qendror dhe lokal, mirëpo pyetja ime ishte, sa keni punuar në atë drejtim, sa jemi angazhuar si komunë me arritur deri te caku.

Alferd Tahirsylaj- sa e di unë vitin e kaluar e keni hedh në votim këtë procedurë edhe besoj pasi që është ish drejtori këtu mundet me e dhënë sqarime sepse ka qenë i kyçur. Florin te veprimtaria sekondare te parqet ne jemi duke kryer punë vullnetare që një vit për një arsye të vetme se punëtorët që kanë pasur kontratë mos të shkojnë në shtëpi na tash jemi në përpilim të kontratës së re dhe janë të specifikuara detajet për secilin se çfarë kanë me kryer, dhe në momentin kur nënshkruhet hyn në fuqi, atëherë kanë me u përfunduar të gjitha ato, sa i përket deponive ilegale janë kompetencë e komunës, tash këtë javë GIZI-i një përfaqësues i kompanisë dhe një i komunës kanë me dalë në teren edhe me i verifikuar deponitë, momentin që i sjellin në raport, në bazë të raportit drejtorja e Shërbimeve Publike e ka obligim me e qit tenderin për eliminimin e tyre. Tash është faza kur bëhet regjistrimi i deponive ilegale çdo vit, dhe në momentin që sillet raporti qitet tenderi dhe e kemi garancinë nga drejtori që kjo punë do të përfundojë. Inkasimi 101% është inaksim që është mbledhur prej borxheve të akumuluar me herët, që kur mbledhet edhe me borxhet që janë faturuar dhe borxhet e mëparshme është rritur inkasimi mbi 100%.

Florin Dreshaj- ani a ka mundësi me e marrë vesh ne sa janë inkasuar prej vitit 2021, pa borxhe, borxhet nuk ishte dashur me i futur në inkasim, sepse tani po dalim shumë të paqartë

Alferd Tahirsylaj- duhet me i futur në inaksim se është aktivitet i yni. Si mi arsyetuar ato pastaj

Florin Dreshaj- mundesh me i arsyetuar, me i ndarë borxhet prej inkasimit të vitit 2022, viti fiskal ka përfunduar me 31 dhjetor 2021, dhe me e ditur sa janë inkasuar për vitin 2021 sa jo. Këtu po del 101% e ende ka borxhe po dalim shumë të paqartë aty. Raporti ka qenë shumë i paqartë dhe i varfër, tri faqe raport është shumë pak.

Alferd Tahirsylaj- mundesh edhe me një faqe me bërë raport.

Florin Dreshaj- jo raport mundesh edhe dy rreshta, por për me e pas raportin e një pune njëvjeçare të një kompanie siç është “Ambienti” ishte dashur pak më shumë e jo tri faqe. Sepse nuk do kishim pasur nevojë me u vonuar këtu shumë me pyetje.

Alferd Tahirsylaj- me rëndësi puna në teren është e mirë.

Florin Dreshaj- unë për punën ju përgëzoja. Edhe një pyetje shtesë e kam. Edhe sa vendbanime i keni të pa përfshira në shërbim?

Alferd Tahirsylaj- vendbanime nuk ka. Ka ndonjë lagje që është e pa qasur rruga për të kryer shërbim por vendbanim nuk ka.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? Faik Alushaj është lajmëruar.

Faik Alushaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha ta bëj një pyetje pak më ndryshe se të tjerët. Punëtorët e ndërmarrjes “Ambienti” këtë vit po punojnë më shumë, desha të pyes kush është përgjegjës për rroga të tyre. I kanë kushtet edhe rrogat mjerisht të vogla. Tani gjithçka është ngritur, me çmime të ushqimit me të gjitha, edhe rrogat i kanë shumë të vogla, e thashë ta dimë se kush është përgjegjës, a kanë të drejtë këta si ndërmarrje me i ngrit rrogat apo komuna?

Alferd Tahirsylaj- sa i përket rrogave, KRM është kompani regjionale e ka një krye shef dhe një ekzekutiv me qendër në Pejë. Rrogat ngritën me vendim të krye shefit, ne si njësi fatmirësisht gjendjen financiare e kemi mirë, kemi bërë kërkesë për rritje të rrogave, por nuk mund të ngritën për Istog e për dy njësi tjera jo. Kështu që jemi në diskutim dhe në pritje që ka me pasur lëvizje në nivel të KRM-së.

Kryesuesi i Kuvendit- dikush tjetër a ka pyetje? I mbetëm borxh koleges Lavdije, legjislatura e kaluar e ka votuar në bashkëpunim me Klinën sepse i kemi pasur disa mosmarrëveshje thjeshtë konceptuale me KRM Peja d.m.th me qendrën. Dihet që prej 100% kompania i ka aksionet, 25% i ka njësia në Istog 25% njësia në Klinë dhe 50% baza në Pejë. Ne jemi të privuar prej shumë gjërave kur vjen puna tek vendimmarrja e statusit të këtyre njësive të Klinës dhe Istogut, Deçani është ndarë zyrtarisht, mirëpo 70% prapë duhet të kthehet në region sepse ligji nuk ja mundëson as Deçanit me qenë i pavarur dhe me marrë vendime, ishte pyetja mjaft e mirë e anëtarit të Kuvendit për paga. Kështu që ministria pjesërisht na e ka kthyer atë, që ju si Kuvend i keni votuar, komisionet e aksionarëve që Klina dhe Istogut të jenë të barabarta në bordin e drejtorëve të menaxhimit të ndërmarrjes. Tani ne i kemi konstituuar komisionet e aksionarëve, dhe

shumë shpejt do të dalë në bazë të afateve ligjore edhe konkursi për bord të stacionit të Autobusëve edhe për një anëtar të bordit të KRM “Ambienti” në Pejë. Kjo ishte, nuk di a isha i qartë Lavdiqe. A ka edhe dikush diçka në lidhje me raportin?

Konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit, gjithsejtë të pranishëm në sallë janë 22 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh në votim, kush e aprovon raportin vjetor të vitit 2021 të ndërmarrjes “Ambienti” në Istog?

Konstatohet që me 22 vota për, aq sa janë të pranishëm aprovohet raporti vjetor i ndërmarrjes “Ambienti” në Istog për vitin 2021.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- sa i përket kësaj pike z. Nënkyetar e keni fjalën.

Nënkyetari i komunës- faleminderit kryesues! Ftoj zyrtarin kryesor financiar që ta bëjë prezantimin me detaje për këtë pikë të rendit të ditës.

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Prezanton pikën e rendit të ditës ‘Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të ndarjes buxhetore për tejkalimin e THV 1 2021.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Osman! A dëshiron ta marrë dikush fjalën? Faik Alushaj është lajmëruar.

Faik Alushaj- Unë e kam një kërkesë fshati Mojtir që 22 vite ka mbetur anash, vetëm rruga kryesore është e shtruar, dhe nuk ka asnjë rrugë tjetër anësore as nuk ka kanalizim, rrymën e ka katastrofë, asgjë në Mojtir nuk është punuar deri tani. A është në plan me u punuar diçka në Mojtir këtë vit apo vitet e ardhshme?

Kryesuesi i Kuvendit- Zyrtari kryesor financiar e ka fjalën.

Osman Sadikaj- Faik, këto janë mjete d.m.th i kemi tejkualuar mjetet e të hyrave vetanake. Sa i përket propozimit të juaj, sigurisht që tani e kemi filluar fazën e planifikimit të buxhetit për vitin 2022, jemi në fazën e Kornizës Afatmesme Buxhetore, do ta kemi edhe një dëgjim publik me qytetarë me Kornizën Afatmesme Buxhetore edhe nga drejtorja jemi në fazën përfundimtare dhe sigurisht edhe nga qytetarët, edhe nga ju pastaj do të jetë ajo e fundit që ju do ta vendosni se cilat prioritete do të jenë që do t’i vendosni për vitin e ardhshëm kjo është për këtë vit 2022, për me e bërë një propozim,

duhet paraprakisht sipas rregullës që për mua ky projekt nuk është prioritet, pra te kjo shumë duhet me qenë e barabartë në mënyrë se çfarë me u heq nga propozuesi.

Faik Alushaj- në Mojstir nuk ka asgjë të përfunduar asnjë metër kanalizim, as rrugë anësore as asgjë elementare përveç asfaltit kryesor. Edhe Mojstiri është pjesë e Istogut dhe duhet me qenë e barabartë. Është punë që duhet me u marrë më seriozisht, se tani të gjithë po duan të largohen prej aty, nuk kanë kushte as për jetesë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Faik! A ke edhe diçka me shtuar Osman?

Osman Sadikaj-tash po jemi në dijeni për problemet e fshatit Mojstir, dhe i sqaron procedurën anëtarit të Kuvendit Faik Alushaj rreth sjelljes së propozimit të një projekti çfarëdo qoftë ai dhe si të përfshihen si projekte me prioritet.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- pajtohem me atë çka u tha se nuk është bërë asgjë për fshatin Mojstir, edhe qytetarët edhe ne kemi propozuar që të bëhet diçka në atë drejtim, e me më rrezik është rryma e dobët, dhe janë në hall të madh, pra është e pa moralshme që dikush të kërkoj ndriçim edhe pse çdo projekt është i rëndësishëm e dikush mos t'i ketë gjërat elementare. E dimë që këtë vit çdo gjë është ndryshe por duhet të shihen se ku duhet të jenë investimet me më prioritet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a dëshiron edhe dikush të diskutoj rreth kësaj?

Konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit, gjithsejtë të pranishëm në sallë janë 22 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- jo nuk hyn Ajshe, se Faiku duhet me heq diçka për me e shtuar si projekt.

Osman Sadikaj- për rastin konkret në fshatin Mojstir duhet të bëhet propozim projekti, kështu që për vitin e ardhshëm ky fshat do të futet në prioritet. Sa i përket rrymës ne nuk po mundemi më parandë publike ta investojmë në KEDS për shkak se është kompani private. Komuna e ka një marrëveshje me KEDS-in pra duhet bashkërisht t'i zgjedhim këto probleme.

Ajshe Metaj- e dimë që keni marrëveshje me KEDS-in por komuna duhet me e ngrit zërin për qytetarët e saj, janë disa gjëra që nuk presin, se më dhimbjen qytetarët se nuk e kam për asgjë tjetër, sepse janë të rrezikuar.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Lidhur me projektin për rrjetin energjetik në komunës së Istogut, nëse jeni të njoftuar tash qeveria që e ka nënshkruar

një marrëveshje me NCM, komuna jonë është e para që ka me përfituar prej kësaj marrëveshje vlere e këtij projekti është 29.5 milionë euro, pra jemi në prioritet edhe për shkak të dëmeve që kanë ndodhur vazhdimisht në rrjetin energjetik. Projekti pritet të filloj në shtator të këtij viti. Ne i adresojmë kërkesat që i marrim prej qytetarëve vazhdimisht, për rrjet që dëmtohet, ka pasur investime ad-hoc nëpër lagje sepse është një rrjet prej viteve të 60-ta, me ngarkesën që ballafaqohet tash është e pamundur me siguruar energji të qëndrueshme. Prioritet për projektin që do filloj janë fshatrat e mbi vadës dhe lugu i Drinit. Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- unë e hedh në votim, kush është që këto mjete të barten?

Konstatojmë që me 15 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime miratohet propozim vendimi për ndarjen buxhetore për tejkalimin e THV 1 2021.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- nënkryetar fjala është për ju?

Nënkryetar i komunës- Osman Sadikaj ka fjalën për prezantimin e kësaj pike.

Osman Sadikaj- prezanton pikën e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2022 dhe 2021.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- po flitet këtu për transportin e nxënësve, janë ndarë diku 15 mijë euro, po dua ta di, cilat kategori të nxënësve transportohen me këtë shumë, në cilat relacione? E kam edhe një pyetje, po thuhet te pagesa për përfituesit individual këtë nuk e kam të qartë?

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori i Arsimit, Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket pyetjes, transportohen të gjithë nxënësit të cilët shkollat i kanë mbi 3 km e gjysmë, faktikisht janë 4 km.

Ajshe Metaj- a mundesh me ma dhënë statistikën e nxënësve në cilat relacione dhe sa nxënës transportohen?

Naim Behlulaj- në relacionin Cerkoz-Uçë 56 nxënës, Veriq-Rakosh 26 nxënës, Kërrninë 20 nxënës, Kosh, Mojstir faktikisht Sinajë, Muzhevinë, të gjitha shkollat që kalojnë nëpër këto km i kemi të përfshira, dhe planifikojmë vitin e ardhshëm që ta zgjerojmë edhe më shumë transportin.

Osman Sadikaj- sa për sqarim, është e vërtetë se fjala përfituesit individual janë nëpër drejtori, asgjë nuk është paragjykuar kush ka me i marrë, por ne ndajmë mjete, qytetarët bëjnë kërkesa në drejtori për ndonjë ndihmë, apo përkrahje. Është rregullorja komunale

e cila është miratuar në Kuvend për ndarje të subvencioneve. Pra pas gjithë procedurës kodi buxhetor quhet përfitues individual.

Enver Rugova- fjalën e ka Faik Alushaj.

Faik Alushaj- një pyetje për drejtorin e Arsimit, a është më në interes me i bartë nxënësit me i sjellë në Istog a me investuar nëpër shkolla në fshatra?

Naim Behlulaj- interesi i DKA-së është që me vazhduar edhe në shkolla të cilat janë paralele të ndara, mirëpo, mungesa e nxënësve po na e bën me e vazhduar transportin, edhe pse, llogaria e DKA-së është transportimi në shkolla amë, për shkak të cilësisë së mësimi.

Faik Alushaj- a është më cilësi me mësuar mësimdhënësi me 12 nxënës apo me 35 ose 40 nxënës? Edhe a bën p.sh nxënësit e mirë me i transportuar nëpër fshatra e me i mbledhë të gjithë në një vend?

Naim Behlulaj- Faik, unë besoj që më mirë është me 12 nxënës, po nuk i ke në secilën klasë 12 nxënës, e ke kombinim, kombinimi është p.sh me paralele e para me të tretën, e dyta me të katërtën, ndahet tabela në mes dhe zhvillohet mësimi.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Hajrush Shoshi

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e pata një propozim konkret rreth buxhetit, te ndërtimi i tregut në Istog që janë ndarë 50 mijë euro, unë e di që janë edhe 80 mijë euro të tjera, propozoj që, t'i hiqen 30 mijë euro dhe të shkojnë te ndërtimi i rrugës "Maksutaj" në Baicë. Te tregu ka mjete edhe për dy vitet e ardhshme, janë të planifikuara në buxhet. Kështu që ky projekt duhet të dalë së paku për tri vite, se qashtu është edhe planifikimi.

Genc Ademaj- faleminderit për pyetjen! Lidhur me projektin e ndërtimit të tregut të ri, ne jemi duke e identifikuar një lokacion të ri, jemi duke i bërë disa matje me disa ekspertë të jashtëm se cili është lokacioni i përshtatshëm. Ne jemi të mendimi që lokacioni i tregut momental të shndërrohet në një park si zonë e rekreative dhe disa parkingje që munden me i shërbyer në të ardhmen palestrës për rritje të kapaciteteve. Lokacioni i planifikuar për momentin është te stadiumi i qytetit te ajo pjesa e jashtme e stacionit të autobusëve, me një kosto prej 400 mijë eurove. Ideja është me e zhvilluar treg tërë ditë e jo javor. Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Urdhëro Hajrush!

Hajrush Shoshi- po vetëm sqarimi i drejtorit, me bindi që vërtet është e nevojshme që kjo punë të përfundohet, sepse deri sa ende nuk është bërë planifikimi dhe jemi muajin e gjashtë si do t'i shpenzoj mjetet, është problem sepse mund të përfundojnë të gjitha procedurat e prokurimit dhe vitin e ardhshëm ti bëjnë planifikimet dhe ta përfundojnë shumë që i duhet projektit.

Genc Ademaj- projekti i anëtarit të Kuvendit është projekt ad-hoc, tani jemi në fazën e planifikimit të qarkores së parë buxhetore ku mundemi me fut si projekt për vitin e ardhshëm. Sa për informim, projekti i tregut ka qenë i përfunduar qysh vitin e kaluar, por nuk ja ka arritur për shkak të procedurave me u ndërtuar, kështu që projekti kryesor është, kush dëshiron mundet me ardhur me e shikuar.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush a mundesh ta lësh për vitin tjetër, nuk po e hedh në propozim fare, po të them para kolegeve se po dua të jem transparentë.

Hajrush Shoshi- mirë nuk problem fare, mirëpo mundem të ju siguroj që në fund të vitit mjetet do të shkojnë në suficit, prej këtij projekti.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, këtu u fol për cilësinë e arsimit, është e vërtetë që klasat e kombinuara vërtetë mësime mbështetëse duhet të jenë të përgatitur, sa janë të përgatitur ndoshta mundet me na e treguar ish drejtor i Arsimit nëse i ka vizituar ato? Edhe një pyetje tjetër, çfarë do të ndodhë me ata punëtorë që ju po konsideroni që nuk po japin cilësi në arsim, ku do t'i dërgoni?

Naim Behlulaj- po profesoreshë, asnjë punëtorë nuk do të jetë papunë. Tani e kemi edhe me udhëzimin e ri administrativ që do t'i dërgojmë mësime mbështetëse që i mbyllin paralelet e ndara si mësues mbështetës.

Ajshe Metaj- vetëm se mësime mbështetëse me sa e di unë, janë të nxënësve me nevoja të veçanta, nëse flasim për mësime mbështetëse ashtu siç unë po e kuptoj duhet atë mësuesin paraprakisht me e dërguar në shtëpi me ja dhënë rrogën e me sjellë një tjetër, si mund të përballohen këto.

Naim Behlulaj- po profesoreshë e kemi buxhetin e planifikuar për të gjithë mësime mbështetëse, mos të keqkuptohemi jo te mësime mbështetëse të cilët nuk kanë cilësi, mirëpo për shkak të mungesës së nxënësve nuk kemi cilësi. Ndërsa sa i përket mësime mbështetëse është buxheti dhe kemi mjete të mjaftueshme që asnjë mos të mbet pa pagë, këta do t'i dërgojmë aty ku ka nevojë sidomos fëmija me nevoja të veçanta.

Kryesuesi i Kuvendit- Hajrush a ke shpjegim, tu ka përmendur emri prej Ajshe, për shkollat të pyeti a i ke vizituar?

Hajrush Shoshi- sigurisht që i kemi vizituar të gjitha shkollat. Edhe është shumë e nevojshme që shkollat që kanë numër të vogël të nxënësve të mbyllën.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- a mund të më tregosh drejtor, se mësime mbështetëse për fëmijë me nevoja të veçanta, duhet të ketë të përfunduar trajnime e shumëçka, që tani janë vetëm

në finalizim dy përfaqësues të komunës së Istogut, pra ata po i kuptoj, se mësuesi në klasë nuk mundet t'i mësoj, mirëpo kjo që ka ndodhur në shkollën tonë është pak më ndryshe, a po i dallon këto dy kategori, apo po i fut në një vend.

Naim Behlulaj- po profesoreshtë i dalloj shumë mirë, edhe fatmirësisht vij prej asaj sfere dhe e njoh arsimin mjaft mirë, mirëpo thashë që mësimdhënësit mbështetës do të shkojnë në trajnime, e kemi edhe në plan program që t'i avancojmë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Ardita Idrizaj.

Ardita Idrizaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha me e pyet drejtorin e Arsimit pse ende nuk është hapur kopshti i fëmijëve "Lulet e Jetës" në Vrellë ku dihet që kanë përfunduar punimet që katër-pesë muaj? Faleminderit!

Naim Behlulaj- është pyetje me vend, ne e kemi një problem për shkak të inventarit që është fituar tenderi, mirëpo kompania tjetër ka bërë ankesë, dhe është në komisionin për ankesa vetëm për shkak të furnizimit me inventar.

Liridona Lajçi Avdijaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha një pyetje për drejtorin, cila është procedura e regjistrimit të fëmijëve, për shkak se këto ditë më ka hasur shumë me këto probleme, se e kam regjistruar vajzën, a është e drejtë e prindit me e zgjedh mësuesin, sepse më është dukur pak absurde pse mos me qenë një metodë tjetër, sepse e kam parë që po krijon konflikte edhe mes stafit edhe me prindër. Pra veç kisha pasur dëshirë ta di përgjigjen se cila është procedura?

Naim Behlulaj- faleminderit Liridonë! Sa i përket procedurave, nuk duhet prindi ta zgjedh mësimdhënësin, duhet të regjistrohet, pastaj drejtoria duhet ta bëj ndarjen e tyre. Fatkeqësisht kjo ka vazhduar dhe ende vazhdon që të zgjidhet mësimdhënësi, për mua janë të gjithë të njëjtë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor!

Konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit, gjithsejtë të pranishëm në sallë janë 19 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është që kjo pikë e rendit të ditës të aprovohet?

Konstatohet që me 19 vota për, aq sa janë të pranishëm miratohet pika e rendit të ditës 'shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019,2022 dhe 2021.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka zyrtari kryesor financiar!

Osman Sadikaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike, 38 Rezerva në Kategorinë Ekonomike, 30-Shpenzime Kapitale.

Kryesuesi i Kuvendit- ajo pjesa e dytë është më e madhe se kjo shuma 400 mijë euro, ku duam t'i marrim pastaj ato mjete me i paguar?

Osman Sadikaj- ata na marrin neve edhe këtë që po e planifikojmë sot, po shpresojmë që deri në fund të vitit mos të ketë më shumë. Ne po e bëjmë një plan, që mundet me dështuar, por prapë se prapë do të jeni të njoftuar për çdo detaj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! A ka dikush diçka për diskutim? Hajrush Shoshi është lajmëruar.

Hajrush Shoshi- vetëm desha me e cekur që këtu nuk janë 400 mijë po 395 mijë euro rezervë, është dashur me e ditur ku po i merr edhe 5 mijë euro, pra tani kuvendi me qenë në dijeni që ku po i heq? Si dhe e kam edhe një pyetje rreth dixhitalizimit të klasave në institucione shkollore është një projekt që dy vite hiqet dhe llogaritet në ministri të Financave që nuk është projekt kapital, ose duhet me ja ndërruar emrin mos të humbin prapë 30 mijë euro, por me e shikuar si duhet me e emëruar.

Osman Sadikaj- sa i përket çështjes së keq klasifikimit të projekteve kapitale, janë dy Rregullore që shumë mirë e shpjegojnë, dixhitalizimi nënkupton softuer (Software) i cili llogaritet shpenzim kapital. Pra këtu nuk e kemi problem atë, rregullohet edhe me këtë emër.

Hajrush Shoshi- në kushte normale pas votimit nuk do ishte dashur askush t'i prek shifrat. Nuk do ishte dashur të bëhen 400 mijë euro. Nëse votohet në Kuvend me 395 mijë euro atëherë mbesin 395 mijë.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka të diskutoj? Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- të gjitha këto bartje që po bëhen janë si rezultat i planifikimit dhe menaxhimit të keq që janë duke e bërë partitë në pushtet po dihet Lëvizja Vetëvendosje është kundër këtyre bartjeve, për shkak se janë anuluar projekte shumë të rëndësishme. Kanalet e ujitjes, kanalizimet janë projekte shumë të rëndësishme, dhe po shihet që me shifra nuk jeni askund. ZKF-ja dha që nuk është obligim i komunës, në qoftë se nuk është pse po e marrim ne përsipër?

Kryesuesi i Kuvendit- profesor po implikohem pak, nuk po dua ta përhumbe atë që e the. Kryeministri e ka nënshkruar këtë në vitin 2017, tash është i treti kryeministër pas tij, këto janë lënë, këto borxhe, ka pasur qeveria, tani nëse nuk dëshiron kjo qeveri që ka ardhur me i paguar, ky problem është në të gjitha komunat, nuk dëshiron me i paguar dhe duhet me i paguar dikush, ne duhet se nuk ka askush tjetër.

Florin Dreshaj- unë nuk pajtohem me këtë. Me çfarë ligji na i merr gjykata mjetet nëse nuk është obligim i komunës. Edhe kur thashë që është planifikim i keq, para një viti kanë kaluar një milionë euro në suficit, vitin e kaluar afro gjysmë milioni ose më tepër, ato kanë mundur të paguhen më herët, tani na i merr neve këtë vit dhe ne mbesim pa gjysmën e projekteve, nuk ka ligj që na obligon neve për diçka që nuk kemi obligim.

Osman Sadikaj- kontratën kolektive nuk e ka nënshkruar komuna, e ka nënshkruar qeveria bashkë me ministrin e Arsimit. Në klauzolë të kontratës shkruan shumë mirë se kush ka pasur obligim, ka pasur ministria e Arsimit dhe e Financave që me qarkoren buxhetore të ndajë buxhet për këto obligime që dalin prej kontratës kolektive. Njëherë nuk ka pasur kërkesa, pastaj ka filluar kjo si një sindromë dhe është e pranishme në të gjitha komunat. Vitin e kaluar nuk kanë shkuar në suficit një milionë por 400 mijë euro, e 560 mijë euro përmes përmbaruesit. Ministri i Financave në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike e ka të drejtën që për momente të caktuara t'i ekzekutoj obligimet pra njëherë nuk kanë pasur obligim, i ka zënë komunat të pa përgatitura, gjykata e ka sjellë vendimin është i plotfuqishëm. Publikisht po e them që komuna ka zero obligim ligjor. Neve po na i marrin mjetet pa dëshirën tonë, por ministri e ka fuqinë ligjore.

Florin Dreshaj- sipas asaj që po thuhet, gjykata e ka sjellë një vendim të jashtëligjshëm. Gjkata është bazuar në diçka, nuk e ka sjellë atë vendim sipas qejfit të vet. Nuk kemi nevojë me fol për të gjitha komunat, ne po flasim për Istog, është planifikim që është bërë gabimisht.

Kryesuesi i Kuvendit- Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- më iku më herët një pjesë ku u tha dixhitalizimi i klasave në institucione shkollore, ku the software, çka po mendon me software? Investim i çfarë software-i, si investim kapital që po e quan?

Osman Sadikaj- nuk e kam në detaje, po ishte kontesti a është shpenzim kapital a jo. E sa i përket ekzekutimit të këtij projekti sigurisht do ta bëj drejtori sqarimin që e ka më të qartë.

Naim Behlulaj- faleminderit Agron për pyetje. Aq sa di dhe mundem me të jap informacion se nuk është lëmi e imja. Ish drejtori Hajrushu ka vazhduar me sjelljen e mjeteve elektronike aty për dixhitalizimin e shkollave. Ne kemi planifikuar me filluar me dixhitalizimin e programeve me bërë një pilot projekt që me startuar në gimnazin "Haxhi Zeka" me dy apo më shumë klasë që me shikuar sa është e kushtueshme, pas informatave që ne i kemi nga ministria është e pamundur me e bërë dixhitalizimin e të gjitha shkollave në nivel të komunës për shkak të kostos së madhe.

Agron Gashi- unë pyeta për arsye se a do të hyj sistemi online, se dixhitalizim është edhe me dërguar kompjuterë edhe projektorë.

Naim Behlulaj- këto që i përmende janë nëpër shkolla, po planifikojmë që çdo e dhënë e nxënësve dhe mësimeve të futet në dixhitalizim.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën?

Ajshe Metaj- unë e pata edhe një pjesë, po por dua të lidhem këtu te dixhitalizmi, në fakt është mirë të bëhet sepse familja direkt është e lidhur me shkollën. Por shtrohet pyetja deri sa në shkollë nuk po kemi mjaftueshëm rrjet si duhet, si do të funksionoj kjo. Edhe pyetja tjetër është ju e përmendet kontratën kolektive që është bërë nga viti 2017, pata kërkesë ta di nga cili kryeministër ka qenë në atë kohë në detyrë sepse për këtë kemi debatuar edhe vitin e kaluar që komuna ka thënë që ne nuk e kemi nënshkruar kontratën, mirëpo pasi u bë ndërrimi i kryeministrave erdhi një tjetër edhe ai e nënshkroi, nuk e ka zënë komunën në befasi, ju kam thënë planifikojeni në buxhet se e keni obligim ndaj punëtorëve të arsimit.

Kryesuesi i Kuvendit- zyrtari kryesor financiar e tha që i ka zënë në befasi vendimi i gjykatës, e jo ajo si kontratë. Nuk është e imja me i përmend emrat e kryeministrave. Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj-përsëritet të gjithë të pranishmit! Unë e pata më shumë si sqarim, disa prej kolegëve kemi nevojë për një sqarim rreth transferit, kështu në përgjithësi. Ne kur të votojmë tash, a votojmë për këto që janë heq, apo për të gjitha projektet në tërësi që janë në pjesën tjetër, p.sh ndërtimi i infrastrukturave që kalon, pra apo votojmë edhe për atë projekt, apo vetëm për ndryshimin. Faleminderit!

Hajrush Shoshi- sqarimi kolegut Niman nuk ju është bërë. Të gjitha janë projekte të reja që janë paraparë prej fondit rezervë edhe po votohen projektet rezerva prej 395 mijë eurove. Këto që kanë qenë momentin e fundit janë hequr, d.m.th ky fond rezervë është krijuar ditën kur është mbajtur mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, për këtë arsye do ishte dashur të bëhej një sqarim se ne kur e kemi marrë materialin e kemi marrë ndryshe. Këto mjete kanë qenë te projektet, pra të gjitha këto janë projekte të reja që do të procedohen në ministrinë e Financave.

Kryesuesi i Kuvendit- është shumë e vërtetë që ndryshimi është bërë pasi është dërguar materiali, duhet me qenë transparent, ndryshimi është bërë për shkak të përmbaruesit.

Ajshe Metaj- këtu mos po i del gabimi zyrtarit kryesor financiar, çfarë ka hequr këtu 'ndërtimi i kanalizimit në lagjen Kada' e ke shkruar 5 mijë euro euro, për 5 mijë euro e ke zvogëluar, a mos ka qenë këtu shuma 10 mijë euro e kur i ke heq 5 mijë kanë mbetur edhe 5 mijë euro.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- unë nuk po e shoh këtë korrekt, pse nuk i keni vendosur në dy fletë, në njërin anë projektet që kanë me i zvogëluar, dhe projektet që nuk janë prekur në anën

tjetër, sepse ne po vendosemi para aktit të kryer. Nëse votojmë po votojmë për këto që nuk po preken, e pastaj po duhet të votohet edhe për ato që janë zvogëluar.

Kryesuesi i Kuvendit- urdhëro Osman Sadikaj e ka fjalën.

Osman Sadikaj- po e bëjmë kështu për me qenë më të qartë. Totali është 1.586.645 për momentin në kategorinë ekonomike rezerva, nga kjo kategori shkojnë në kapitale transfer 1.886.645 ndërsa mbasin rezervë 400 mijë euro. A është e qartë.

Niman Beqiraj- ne jemi kundër me u zvogëluar projektet, por jemi për me u votuar këto projekte të cilat nuk janë prekur. Duhet me votuar për edhe pse jemi kundër ndryshimit.

Kryesuesi i Kuvendit- Genc Ademaj e ka fjalën.

Genc Ademaj- në kohën kur e kemi iniciuar materialin, për mbledhjen e KPF-së kemi pasur njoftime prej Thesarit për procedurë përmbartimore, që janë marrë 178 mijë euro, për këtë arsye jemi obliguar t'i zvogëlojmë projektet, bashkë me juve në mbledhje jemi marrë vesh që 400 mijë euro me qenë në kategorinë rezerva, që ne me pas hapësirë dhe me ja filluar implementimit të projekteve që i kemi propozuar para jush. Ne e kemi një informacion që një shumë diku rreth 200 mijë euro veç ka me ardhur, por janë vonuar ata zyrtarët ligjor në Thesar. Kështu që ky 400 mijë euro ende pa i kryer procedurat e bartjes kane me u shpenzuar. Fatmirësisht me disa zyrtarë në ministrinë e Financave kemi rënë dakord që me e bërë para alokimit e pagave dhe mëditjeve në drejtorinë e Arsimit. Unë po e kërkoj nëse po mund ta gjej gabimin dhe ta përmirësoj menjëherë para se me e aprovuar.

Kryesuesi i Kuvendit- gabimi është gjetur, një bartje që nuk është bërë.

Genc Ademaj- d.m.th ndërtimi i infrastrukturës në varrezat e fshatit Kërrninë e Epërme dhe e Ulët ka qenë e zvogëluar për 20 mijë euro në këtë tabelë, në tabelën paraprake që e kemi përcjellë ka qenë 25 mijë euro. D.m.th këtu ishte ai gabimi i 5 mijë eurove.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë për debatin! E hedh në votim, kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës 'shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike, 38 Rezerva në Kategorinë Ekonomike, 30-Shpenzime Kapitale.

Konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit, gjithsejtë të pranishëm në sallë janë 20 anëtarë të Kuvendit.

Konstatohet që me 16 vota për, 4 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës 'shqyrtimi dhe miratimi i Transferit nga Kategoria Ekonomike, 38 Rezerva në Kategorinë Ekonomike, 30-Shpenzime Kapitale.

Kryesuesi i Kuvendit- unë i kërkoj falje z. Driton Marku nga OSBE që ndoshta është dashur të ja jap fjalën në fillim. Fjala është për ju.

Driton Marku përfaqësues nga OSBE-ja- përshëndet të gjithë të pranishmit! Departamenti i demokratizimit i OSBE-së organizon një trajnim dy ditor për anëtarët e rinj në moshë të Kuvendeve komunale. Kështu që ju subjektet politike duhet ta emëroni nga një përfaqësues që është në moshën deri 35 vjeçare.

Anëtarët e Kuvendit kanë rënë dakord për përfaqësuesit e partive që do të marrin pjesë në trajnimin dy ditor.

Shqyrtimi i pikës 8.

Përgjigjet e pyetjeve nga ana e drejtorëve të parashtruara nga anëtarët e Kuvendit në mbledhjen e fundit të Kuvendit.

Abedin Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Pyetje në adresë të drejtorisë së Shërbimeve Publike nga ana e anëtares së Kuvendit Ajshe Metaj lidhur me bus stacionet. Përgjigja është që projekti i riparimit të bus stacioneve është tenderuar tash shumë shpejt pritet edhe oferta me u realizuar edhe me u kontaktuar kompania se e di që është në gjendje jo të mirë gjendja e bus stacioneve.

Profesori Qerim Rexhaj ka pyetur lidhur me kanalizimet në lagjet e fshatit të Cerrcës, kam qenë aty e kam parë që ka mungesë të kanalizimit, është prioritet i drejtorisë që gjatë këtij mandati të përfundohet.

Agron Gashi ka pyetur lidhur me vendosjen e pengesave ose policëve të shtrirë te rrugët e qendrës te parku, afër gjimnazit dhe shkollës fillore në Istog. Përgjigja është që për momentin drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka kompani të kontraktuar, për ata edhe ka mbetur sepse lënda është në OSHP, unë jam duke e shikuar mundësinë që me e kopjuar modelin e këtyre komunave që i kemi afër Klinës Pejës dhe Deçanit e kam vërejtur që i kanë bërë me asfalt, dhe ndoshta kishte me qenë mirë me shkuar edhe ne në sistemin e tyre. Niman Beqiraj ky pyetur për trotuarin nga Zallqi deri në Drejë. Kisha pasur dëshirë me e marrë vesh për cilën është fjala, prej qendrës aksi rrugor që është deri te shkolla, për momentin nuk është e paraparë, sigurisht që duhet të parashihet.

Niman Beqiraj- pikërisht kam folur për atë pjesën, aty ka qenë kërkesë edhe për një mbrojtëse.

Abedin Kabashi- po në pyetjen e dytë ke kërkuar ke thënë, kombi bus deri në shkollë nga komuna, kësaj pyetje ju përgjigj drejtori më herët.

Ardita Idrizaj ka pyetur rreth betonimit të kanalit të ujitjes lagja "Idrizaj" në fshatin Lubozhdë. Është në projekt Ardite, ajo punë do të kryhet.

Shtëpia në lagjen "Nurçaj" në Kashicë ajo është ndërtuar me vet financim.

Ajshe Metaj- veç pak më të qartë se aty ka kundërthënie me qytetarët, vet qytetarët e atij vendi mbajnë se diku i lejohet të mbahet e pame e diku jo. Komuna në vend se me i harmonizuar aty nuk ka vepruar mirë.

Abedin Kabashi- ata e kanë filluar vet, pastaj komuna i ka përkrah.

Ajshe Metaj- qytetarët janë të frustruar, po kërkoj sqarim në detaje, se ti në atë kohë nuk ke qenë këtu kur ka ndodhur ndërtimi. Pres përgjigje në mbledhjen e ardhshme.

Abedin Kabashi- kam marrë informata, kam pyetur, me kanë thënë që ata që kanë participuar me mjete kanë të drejtë me e shfrytëzuar.

Florin Dreshaj- prona e kujt është? Në qoftë se kanë investuar vet, a është prona e tyre apo e komunës.

Abedin Kabashi- nuk e di saktë por sigurisht është pronë komunale.

Florin Dreshaj- në qoftë se është pronë komunale ishte dashur me ja mundësuar edhe të tjerëve, por drejtori tha që nuk e di sigurt a është pronë komunale.

Hajrush Shoshi- raste të tilla kemi në shumë fshatra, ata janë bashkuar dhe kanë mbledhur mjete për me e ndërtuar, dhe kush do qoftë tjetër ka drejtë të ndërtoj, ajo është e mirë e fshatit nuk është pronë komunale. Nuk mundet të ja imponon as komuna një investim vetanak e kanë bërë bashkërisht.

Nexhmedin Balaj- Hajrush pyetja ishte a është pronë komunale.

Hajrush Shoshi- prona është e mirë e fshatit.

Kryesuesi i Kuvendit- prona e mirë e fshatit është pronë komunale.

Abedin Kabashi- i kisha sugjeruar të gjithë anëtarët e Kuvendit pavarësisht a janë pozitë apo opozitë le të më kontaktojnë le të vijnë në zyre, tash që kemi me i bërë projektet për vitin 2023, shumë pak anëtarë të Kuvendit kanë ardhur në zyrën time për me i cekur shqetësimet që i kanë. Nuk është e thënë me i cekur problemet e vendit nga vini, por edhe me dalë përtej fshatit.

